



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 855 Prot.

Tiranë, më datë 01.07.2022

VENDIM

Nr. 327, datë 01.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.07.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor - shkencor “Dioqeza e Sappës, ekspeditë informative 2022” me aplikues Akademia e Studimeve Albanologjike dhe drejtues projekti Paulin Pushimaj, Instituti i Arkeologjisë;
2. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit, si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

